

PKR.nr.96/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit B.N, për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 të KPPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.709/2014 të datës 24.02.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt: **21.07.2017** në prezencën e të akuzuarit B.N, mbrojtësit të tij av.Rr.H dhe prokurorës së shtetit Shemsije Asllani, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

B.N, nga i ati E dhe e ema H, i vajzerise B, i lindur me *data e lindjes* në f.sh. G, K-G, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, student, në vitin I-rë, i martuar, baba i një fëmiju, punëtor në treg në Fushë Kosovë, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal: *numer pesonal*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datën: 29.05.2014 rreth orës 20:25, në rrugën ‘Bekim Mahla – Murrizi’< në Glllogoc, I pandehuri B, ka poseduar dhe ka përdorë paranë e falsifikuar dhe me qëllim që të njëjtën ta vë në qarkullim si të vërtetë në atë mënyrë që ka shkuar në marketin ‘B’, në adresën e sipërshtënuar dhe punëtorit të atij marketi – shitësit S.Q, I’a ka dhënë kartëmonedhën prej 500 euro, me numër serik X11780820974, në emër të pagesës për gjëra të ndryshme ushqimore, të cilën pasi shitësi e ka verifikuar dhe ka dyshuar se është e falsifikuar, nëpërmes telefonit ka lajmëruar policinë të cilët pasi kanë shkuar në vendin e ngjarjës, kanë sekuestruar kartëmonedhën dhe me rastin e verifikimit dhe ekspertimit nga Laboratori I Forenzikës, ka rezultuar konstatimi se kartëmonedha në fjalë është plotësisht e falsifikuar,-

-me çka ka kryer veprën penale: Falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 të KPPK-së

Andaj gjykata me aplikimin e neneve: 2,3,7,17,41,42,49,50,51,53,73 të KPRK-së nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Të akuzuarit B.N për veprën penale: Falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 të KPPK-së, i shqiptoi **DENIM ME KUSHT-DENIM BURG**, në kohëzgjatje prej **një (1) viti**, i cili denim nuk do të ekzekutohet, nese në periudhën kohore prej **dy (2) vite**, i gjykuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

MBI DENIMIN PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit B.N i konfiskohet bankënota në vlerë prej 500 € (pesëqind) euro, me numër serik: X11780820974, si mjet i kryerjes së veprës penale, e cila kartëmonedhë është sekuestuar nga policia e Kosovs, dhe e njehta shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I gjykuari **B.N**, obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej **30 € (tridhjet) Euro**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP.nr.709/2014, të datës 24.02.2015, kundër të akuzuarit B.N për shkak të veprës penale: Falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 21.07.2017 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sçarim shtesë, dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos te pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari pas konsultave të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranoi fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurorja e shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, në prezencën e mbrojtësit të tij, pas konsultave të mjaftueshme me të njëjtin dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabime faktike.

Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të

njejtën ditë vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marr parasyshë se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasyshë të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasyshë pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, i martuar, baba i një fëmiu, punëtor në treg në Fushë Kosovë, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë jo i gjykuar. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtën do të arrihet qëllimi i denimit .

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues gjykata e morri në bazë të nenit 62 par.2 nën par.2.7 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.96/15, të dt. 21.07.2017**

**Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri**

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate